



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË VLORË TË
Z. BAKI AVNI JAZAJ PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
30 QERDHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 16.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për regjistrimin e kandidatit për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Vlorë z. Baki Avni Jazaj, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a" neni 67, pika 2, neni 165, pika 3 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga kandidati për Anëtar në Këshillin e Bashkisë si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Në bazë të nenit 67, pika 2 dhe nenit 72 dhe 165, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", z. Baki Avni Jazaj ka depozituar në KQZ "Kërkesën për regjistrim si kandidat për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Vlorë.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të rregjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e Bashkisë Vlorë, pasi Bashkia Vlorë, administrohet nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë listuar:



Nr. 448 i Vendimit

Data 16.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për regjistrimin e kandidatit për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Vlorë, z. Baki Avni Jazaj për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

1. Kërkesë për regjistrim e z. Baki Avni Jazaj si kandidat për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Vlorë;
2. Deklaratat e kandidatit i cili deklaroi se gëzon të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Vlorë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019;
3. Vërtetim i Këshillit të Bashkisë Vlorë, nr. 3890 prot., datë 05.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se z. Baki Avni Jazaj është zgjedhur prej tre mandatesh në Këshillin e Bashkisë Vlorë;
4. Vërtetim i Këshillit të Qarkut Vlorë, nr. 906 prot., datë 06.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se z. Baki Avni Jazaj është Anëtar i Këshillit të Qarkut Vlorë, që nga viti 2007 e në vazhdim.
5. Certifikatë personale e z. Baki Avni Jazaj sipas së cilës rezultoi se z. Baki Avni Jazaj është me vendbanim në Bashkinë Vlorë;
6. Jetëshkrimin e z. Baki Avni Jazaj si kandidat për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Vlorë;
7. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
8. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit.
- 9.

Z. Baki Avni Jazaj, referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 11.05.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2326.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për të kandidatit për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Vlorë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Baki Avni Jazaj, rezultoi se: në pikën 2 të formularit të vetëdeklarimit "A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një 135shtje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë?" është përgjigjur me "Po", duke deklaruar se me vendimin nr. 62-2019 – 2343 (191) datë 30.04.2019, Gjykata e Fierit, e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Drejtim mjete në mënyrë të parregullt, largim nga vendi i aksidentit", parashikuar në nenet 291 dhe 273 të Kodit Penal dhe në bashkim të dënimeve dënohet me 6 muaj burgim. Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.P dënohet me 4 muaj burgim. Në zbatim të nenit 63 K.P pezullohet ekzekutimi dënimit për pjesën e mbetur 3 muaj e 25 ditë burgim, duke e zëvendësuar këtë dënim me 129 orë punë me interes publik pranë Bashkisë Vlorë, për një periudhë prej 6 muaj.

KQZ gjithashtu ka publikuar formularin e vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Nga verifikimi i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve z. Baki Avni Jazaj nuk është në kushtet e nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, për refuzimin e tij si kandidat për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Vlorë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës __.05.2019, verifikoi dokumentacionin e kandidimit të kandidatit për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Vlorë, dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pikat 2, neni 165 nenin 72 dhe neni 73 të Kodit Zgjedhor.



PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

V E N D O S I:

1. Të regjistrojë si kandidat për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Vlorë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, z. Baki Avni Jazaj.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

